

KONTRATË TRANSFERIMI KUOTASH

Sot më datë 04.11.2021, palët e mëposhtme ekzekutojnë kete kontrate transferimi kuotash ("Kontrata") si vijon:

Floran Pustina, rezident në Tiranë, lindur më 08.02.1977, me nr. personal H70208073S;
Flonja Boriçi, rezidente në Tiranë, lindur më 22.07.2972, me nr. personal M25722043S;
Florian Hasko, rezident në Tiranë, lindur më 14.06.1982, me nr. personal I20614168D;
Idlir Themeli, rezident në Tiranë, lindur më 13.07.1984, me nr. personal I40713103J; bashkarisht këtu e në vijim, referuar si "**Shitësit**"; dhe

Taulant Musabelliu, rezident në Tiranë, lindur më 21.10.1980, me nr. personal I01021087U, këtu e në vijim referuar si "**Blerësi**";

secila palë vecmas referohet si "Pala" dhe së bashku referuar si "**Palët**";

Parashtrime:

- A. Palët janë ortakë në shoqërinë tregtare **K-O-M-A-N shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në QKB me NUIS M02402008K me adresë Blv Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, no 24, 1019 Tiranë (referuar këtu e më poshtë si "**Shoqëria**").
- B. Shitësit zotërojnë bashkarisht 4 kuota që përfaqësojnë 65 % të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë ("**Kuotat ne Shitje**"), si me poshtë:

Floran Pustina, rezident në Tiranë, lindur më 08.02.1977, me nr. personal H70208073S, zotëron 1 (një) kuotë, në vlerë 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

Florian Hasko, rezident në Tiranë, lindur më 14.06.1982, me nr. personal I20614168D, zotëron 1 (një) kuotë, në vlerë 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

Flonja Boriçi, rezidente në Tiranë, lindur më 22.07.2972, me nr. personal M25722043S, e cila zotëron 1 (një) kuotë, në vlerë 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

Idlir Themeli, rezident në Tiranë, lindur më 13.07.1984, me nr. personal I40713103J, zotëron 1 (një) kuotë, në vlerë 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 5% (pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

C. Blerësi zotëron 1 (një) kuotë, në vlerë 350,000.00 (treqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 35% (tridhjetë e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

D. Shoqëria ka një kapital prej 1,000,000 Lek, i cili nuk është shlyer nga Ortakët.

E. Me anë të kësaj kontrate Palët bien dakort që Shitësit të kalojnë në favor të Blerësit, Kuotat në Shitje, që i korrespondojnë 65% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë.

Palët e sipërpërmendura me vullnetin e tyre të lirë e të plotë ranë dakort si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Nëpërmjet kësaj kontrate, Shitësit do të transferojnë në favor të Blerësit, të gjitha Kuotat në Shitje që ata zotërojnë në Shoqëri, të cilat përfaqësojnë bashkarisht 65% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 2
Çmimi i transferimit të Kuotave në Shitje

2.1 Palët kanë rënë dakort midis tyre që çmimi i transferimit të 4 (katër) Kuotave në Shitje është shuma 1 (një) Euro ("**Çmimi i Shitjes**"). Çmimi i Shitjes është dakordësuar mes Palëve, duke patur parasysh pikën (D) të Parashtrimeve më sipër.

Neni 3
Bërja Efektive e Kontratës dhe Regjistrimi

3.1 Kjo Kontratë do të bëhet efektive menjëherë në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

3.2 Kjo Kontratë do të depozitohet dhe regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("**QKB**") dhe regjistrimi i Blerësit si pronar ligjor i Kuotave në Shitje do të bëhet menjëherë me firmosjen e saj nga Palët.


Neni 4
Dispozita përfundimtare

Kjo kontratë është hartuar në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore.

Palët deklarojnë se janë dakort me përmbajtjen e kësaj kontrate dhe se e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të lirë.

Blerësi:

Taulant Musabelliu




K.O.M.A.N SHPK


M02402008K

Shitësit:


Floran Pustina



Flonja Boriçi



Florian Hasko



Idlir Themeli

